



NJOFTIM

Të nderuar fermer,

Bashkia Finiq njofton gjithë fermeret se ka filluar procedura për pajisjen më certifikatën e pronesisë mbi tokën bujqesore ndarë me ligjin 7501.

Procedura e Regjistrimit të akteve të Marjës së Tokës në pronesi bëhet në mbështetje të ligjit Nr.994 datë 9.12.2015.

Drejtoria e Administrimit dhe Mprojtjes së tokës pranë bashkisë Finiq kërkon nga ana juaj të paraqesni këto dokumenta:

- 1) Kërkesë për aplikim
- 2) Fotokopjen e kartës së indetitetit
- 3) Aktin e marjes së tokës në pronësi (tapi) në original
- 4) Certifikatën familjare të 1 Gusht 1991
- 5) Vertetim nga zyra e tatim taksave që është paguar toka deri në vitin 2016

Dokumentat e mesipërme paraqiten në Drejtorinë e Administrimit dhe mbrojtjes së tokës në zyrat e njesisë administrative Aliko

Për rastet që fermerët janë pajisur me certificate nga hipoteka të paraqiten me fotokopjen e certifikateve përkatëse.

Për sqarimet të mëtejshme do të kontaktoni në telefonin e mëposhtëm:

Anesti Karkasina: 0692985906.

Procedura:

- 1- Diten e dorezimit të dokumentave do të keni me vete dhe Aktin e Marjes së Tokës në Pronësi (Tapi) origjinal për ta krahasuar atë me dokumentat që disponojmë ne.

- 2- Do te plotesohet nga ana juaj gjithmone me ndihmen tone, nje kerkese qe doni te pajiseni me certifikata pronesia per token dhe nga ana juaj do te na lini nje numer telefoni.

Nga momenti i dorezimit te dokumendave nga ana jone fillon puna per trajtim te tapise per cdo ngaster te regjistruar dhe pergatitet praktika rreth kater faqe e detajuar per cdo ngaster e numer pasurie dhe per cdo elemend te tapise e cila firmoset nga ana jone dhe percillet per firme e vule tek Kryetari i Bashkise dhe prej andej dokumentacioni i percillet Z.V.R.P.P Sarande ku ju do te kryeni aplikimin prane sportelit per marrjen e certifikatave te pronesia.

Te nderuar fermere!

Ka kaluar nje periudhe e gjate qe kur jini pajisur me Aktin e Marjes se Tokes ne Pronesi (Tapi) e cila munde te jete humbur mund te jete grisur ose eshte e palexushme per rastet e kesaj natyre do te kini ndihmen tone.

Gjate trajtim te Tapise siperfaqja e tokes bujqesore te perfituar nga ana juaj mund te jete me teper ose me pak nga Tapia, ju do te pajiseni me certifikata pronesia per siperfaqen qe ka Tapia duke zbritur pjesen e tepert ne nje nga ngastrat qe deshironi ju dhe per kete do te shpreheni me deklarate noterjale me qellim qe te plotesohet siperfaqja me pak qe kane bashkefshataret tuj.

Gjithmone per baze do te mirret Siperfaqja e Hartave Treguse te Regjistrimit HTR.